

Restaurohet Kisha e Shën Thanasit, një tjetër itinerar kulti



Përfundon puna për restaurimin e Kishës së Shën Thanasit në Leshnicë.

Specialistë të DRKK Vlorë inspektuan punimet restauruese të kryera në këtë monument, të cilat konsistuan në konsolidimin e çarjeve në muraturë; ringritjen e kolonave, konsolidimin e kupolave dhe qemerëve egzistues me strukturë guri; ringritjen e murit anësor në pjesën jugore të kishës; ndërtimin e çatisë së narteksit; ndërhyrjen konsoliduese dhe restauruese në pikturën murale si dhe sistemimin e ambienteve të jashtme.

Kisha e Shën Thanasit, monument kulture i kategorisë së I, ju nënshtrua procesit të restaurimit, si pasojë e dëmtimeve të rënda të elementëve strukturorë të kishës.
[/a.a/](#) [/a.g/](#)

TIRANË, 22 dhjetor /ATSH/







